

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KORÇË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, me objekt: *“Mbi zbatimin e procedurës ligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme, evidentimin dhe trajtimin ligjor të mbivendosjeve”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 179, datë 31.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 710/7, datë 31.12.2013, i ka rekomanduar z. Raqi Themeli, Regjistruer i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

1.- Nga ZQRPP të hartohen, përditësohen e miratohen

a. *“Rregullorja për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”* pasi rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999, është ajo e para 14 vjetëve, e cila ka humbur aktualitetin dhe të përshtatet me ndryshimet ligjore, në zbatim të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 *“Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”*,

b. Rregullorja tip e Funkcionimit të ZVRPP, dhe Organigrama në përputhje me Strukturën Organizative, harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, me synim të ngritjes dhe funksionimit të Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) të Njësisë, për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj publikut, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”*.

2.- Nga ZQRPP të rishikohen, urdhrat e Kryeregjistruesit nr. 1049, datë 10.9.2012 *“Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012 ”Për caktimin e Listës së Shërbimeve që Ofron ZRPP”*, urdhri nr. 1191, datë 5.11.2012 *“Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”*, ku afati maksimal i përfundimit të procedurës zgjat nga 1 ditë deri 30 ditë, pasi:

Nga auditimi i ushtruar në ZVRPP Korçë ka rezultuar se

Të dy urdhrat e mësipërm nuk i japin zgjidhje problemeve në drejtimet si më poshtë:

-Disa qindra praktika kanë mbetur ende tek punonjësit edhe pas dërgimit të Aktverifikimeve (AV), brenda afatit mujor, të paktën gjatë fundvitit 2011 dhe 2012, ndërsa ato duhej të arkivoheshin në arkivë, dhe duhej bërë edhe një njoftim përfundimtar kërkuesit, duke e vënë në dijeni se praktika ndodhet e arkivuar si dhe për shërbimin e pa marrë (dokumentin e pa marrë), është kreditor për shumën përkatëse të vlerës së paguar në aplikim. Kjo masë do të rriste transparencën ndaj publikut, dhe do të siguronte integritetin e ZVRPP dhe të punonjësve të saj.

- Të ardhurat e vjela nga aplikimet e qytetareve dhe duke mbetur praktikat pa zgjidhur dhe në proces, janë të ardhura të arkëtuara sakohë që shërbimi-produkt nuk është kryer nga kjo zyrë ndërsa qytetari ka paguar duke mos marrë produktin- shërbimin e kërkuar.

Nga llogaritje e përafërt nisur me një tarifë mesatare rezulton se gjatë viteve 2011-2012 të ardhurat e realizuara nga aplikimet e mbetja e praktikave në proces luhaten 1120 mijë lekë deri 3320 mijë lekë për vitin 2011 dhe 1293 mijë lekë deri 2178 mijë lekë në vitin 2012.

Nuk është çelur llogaria *“Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”*, ku të evidencoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera, si dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkivë, e duke mos i lënë në duar të punonjësve me afate 1-2 e më shumë vite, në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative

KPA, si dhe hap pas hapi me sjelljen e dokumentacionit të munguar nga qytetarët, të vazhdonte procedura e tërheqjes së praktikës për përpunim nga arkiva dhe përfundimin (mbylljen) e praktikës me përfundimin e kryerjes së shërbimit ndaj qytetarit. Kjo mënyre të vepruar rrit transparencën, shmang varësinë e qytetarit dhe krijimin e idesë subjektivizmit dhe apo dhe të paragjyqimit të shërbimit të kësaj zyre shtetërore ndaj qytetarit taksapagues.

-Dorëzimi dhe arkivimi në arkivë i praktikave në proces menjëherë pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, bashkë me njoftimin ti bëhet e ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditore ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i arkivuar pranë ZVRPP, në pritje deri në 1 muaj, pas këtij afati qytetarit aplikues i kthehet shuma e paguar.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga ZVRPP Korçë të merren masa dhe të zbatohen detyrat e dërguara nga auditimi KLSH me shkresën nr. 253/14, datë 8.10.2008 dhe të ndiqet procedura ligjore për verifikimin e titujve të pronësisë të pasurive në mbi 196 AMTP në ZK 8561 dhe ZK 8564 me sipërfaqe 356 809 m² tokë bujqësore, në mbi 121 AMTP në ZK 3819 me sipërfaqe 965 040 m² tokë bujqësore, në 14 pasuri të llojit ndërtesa e troje në zonë urbane ZK 8562, në 10 pasuri të llojit ndërtesa e troje në zonë urbane ZK 8561, dhe për 6 pasuri të regjistruara sipas nenit 24/b në zonë urbane ZK 8561.

2. Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

a. Për pasurisë nr. 4/937 vol 41 faqe 233, zk. 8561 deri në plotësim të dokumentacionit, dhe ne likuidimin e kamatëvonesës së pa llogaritur e të pa arkëtuar nga regjistrimi hipotekar i vonuar.

b. Për pasurinë nr. 2/31, në vol 27, faqe 113, zk 8561 deri në plotësim të dokumentacionit dhe vendosjen e vlerës së rivlerësuar, dhe

- për pasurinë nr. 3/342, vol 14, faqe 137, zk. 8561 deri në plotësim të dokumentacionit dhe vendosjen e vlerës së rivlerësuar në të kundërt anulim i rivlerësimit pra heqja e shënimit në rubrikën “përshkrimi të veçantë, në zbatim të udhëzimit nr. 21, datë 26.2.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008”Për Tatimin e Kalimit të së Drejtës së Pronësisë të Pasurisë së Paluajtshme“.

2/1. Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa, për plotësimin e dokumentacionit të mangët dhe të munguar të pasurive të regjistruara dhe konkretisht;

- pasuritë nr. 8/41, vol 19/203, nr. 8/89, vol. 19/205 dhe nr. 8/88, vol 19/204 të llojit truall në zonën urbane, zk 8561 secila me sipërfaqe më vete, gjithsej 550 m², deri në plotësim të dokumentacionit për regjistrim të lejes ndërtimit.

- pasuria nr 3/547 v. 23, f. 23 zk 8561 për plotësim të dokumentacionit

- pasuria nr. 5/578, vol 42, faqe 84 zk 8561 për plotësimin e dokumentacionit

- pasurinë nr. 4/424, v. 14, f. 99) zk 8561 për plotësimin e dokumentacionit

- në pasurinë nr. 2/35, v. 42, f. 171, zk 8561 deri në plotësimin e dokumentacionit

- pasuria nr. 2/293, vol. 41, f.189, zk 8561, për ndarjen e sipërfaqes truallit nga toka bujqësore

- pasuria nr. 4/10- N 15, vol 41/190, zk 8561, për saktësimin e sipërfaqes takuse të truallit

- pasuria nr. 4/315, vol 16/40, zk 8561 për saktësimin e sipërfaqes takuse të truallit

- pasurinë nr. 1/120, v. 42, f. 122 zk 8561, për saktësimin e sipërfaqes takuse të truallit

- pasuria nr. 1/114+2-8, v. 42, f. 143 zk 8561, për saktësimin e sipërfaqes takuse të truallit

- Pasuritë vol. 21, fq 121 (21/121), 21/89, 21/31, 1/90, 20/117, 20/50, 20/96 dhe 20/120, zk 8561, për plotësimin me hartat origjinale, përgatitur nga eksperti që i bashkëlidhet Vendimit të gjykatës, dhe të bëhet rakordimi i sipërfaqeve të pasurive përkatëse ne kartelat e pasurive volum 21 me pasuritë ne volum 17, dhe me pasuritë sikundër përcaktuar ne Vendimin e Gjykatës, të gjitha këto.

3. Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

a. Për 42 pasuri bujqësore me sipërfaqen prej 19371 m² të llojit arë dhe arë+truall, ZK. 3088 Fshati Qatrom, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve tepër ne pronësi Seksioni C “shtet”, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën nr. 2 “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3088 Fshati Qatrom Rrethi Korçë”.

b. Për **30 pasuri bujqësore me sipërfaqe 11494 m²**, të llojit arë dhe arë+truall ZK. 3088 Fshati Qatrom, për të cilat është lejuar lëshimi i certifikatave të pronësisë dhe janë kryer transaksione, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin e sipërfaqeve tepër dhe regjistrimin ne pronësi Seksioni C “shtet”, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar.

4. Regjistruesi i ZVRPP Korçë në të ardhmen të mos kryejë asnjë veprim juridik apo transaksion mbi pasuritë bujqësore pa kryer më parë rakordimet e përputhshmërisë ndërmjet sipërfaqeve sipas titullit të pronësisë AMTP, me sipërfaqen në fakt sipas matjeve të Printim III,(LN) dhe duke konfirmuar e verifikimin e titullit të pronësisë në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012.

5. Regjistruesi i ZVRPP Korçë të ndjekë procedurat ligjore në zbatim të përcaktimeve të pikës 3, neni 37, neni 89 dhe pika 1 e nenit 60 të ligjit nr.33/2012 datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, për çeljen e kartelës nxjerrjen e urdhrit administrativ për regjistrimin e kufizimit, me afat dhe në përputhje me formën e përmbajtjen e aktit administrativ, të pasurisë nr. 7/954, v. 26, fq. 211, zk 8564, e llojit truall në sipërfaqen 473 m² të konstatuara të mbivendosura dhe të pa proceduara sipas ligjit në fuqi nga ZVRPP Korçë, si dhe të njoftohen palët.

6- Regjistruesi i ZVRPP Korçë të ndjekë procedurat ligjore për çeljen dhe saktësimin e kartelave dhe HTR-ve të pasurisë së lënë pa regjistruar dhe pakthyer prej 480,4 m², fituar me Vendimin nr. 16, datë 22.1.2007, të ZRKKP Qarku Korçë -Vendim Gjykatës Korçë nr. 3067, datë 6.11.2009, lënë ne fuqi me Vendimin nr. 295, datë 7.7.2010 të Gj.Apelit Korçë dhe plotësimin me dokumentacionin e duhur ligjor të transaksioneve të kryera mbi pasuritë nr. 187/62, v.25, f.197, zk.2631 Fshati Mborje e llojit arë me sipërfaqe 3700 m², nr. 187/61, v. 25, f.196, zk.2631 arë me sipërfaqe 650 m², nr. 187/24, v.12, f.4, sip. 2020 m² arë, nr. 187/63, v.27,f.54, me sip. 1077,33 m² arë por e kthyer në truall, nr. 187/64, v.27,f.55 me sip. 942,67 m² e llojit arë, me pronar “Shtet”, nr. 187/55,v. 22, f. 170, Zk 2631 me sipërfaqe 2520 m², (e cila rezulton të jetë ndarë në pasurinë nr. 187/60, v. 25,f. 195 me sipërfaqe 1870 m² dhe nr. 187/61, v. 25, f. 196 me sipërfaqe 650 m² “shtet”); si dhe të njoftohen palët, në zbatim nenit 37 pika 3, nenit 59 dhe nenit 60, pika 1 të ligjit nr. 33/2012 datë 29.4.2012”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

7- Regjistruesi i ZVRPP Korçë, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga aktet ligjore përmbartimore e Vendimet e Gjykatave për sjelljen e palëve në pozita të barabarta ligjore. Gjithashtu ZVRPP të ndjekë, si palë e përgjegjshme e shkaktare, të gjitha procedurat dhe seancat gjyqësore lidhur me shkaktimin e mbivendosjes mes palëve për sipërfaqen prej 583 m² truall për pjesën me nr. 2/380 të pasurinë, v. 11, fq. 125 zk 8564 e llojit truall, si dhe për trajtim të pabarabartë të palëve pas shkaktimit të kësaj mbivendosje. Konkretisht ZVRPP Korçë me veprimet dhe mosveprimet e saj, **ka shkaktuar** trajtim të pabarabartë të palëve, parregullsi në regjistrimin e çeljen e kartelës së pasurisë së mbivendosur, mosnxjerrjen e urdhrit administrativ për regjistrimin e kufizimit, me afat dhe në përputhje me formën e përmbajtjen e aktit

administrativ, moszbatimin në kohë të Vendimeve të gjykatave, Vendimeve të Përmbarrimit, moszbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, ndërkohë paralel dhe njëkohësisht, ka lejuar kryerjen e veprimeve dhe transaksioneve mbi njërën prej pronave (edhe pse palët ishin në konflikt për disponimin e kësaj mbivendosje), në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 7843, datë 19.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, i ndryshuar dhe me rregulloren nr. 184, datë 18.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme“, të ndryshuar Kreu i VI, pikat 5 dhe 5.2, në zbatim të ligjit nr.33/2012 datë 29.4.2012.

8- Nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë të ndiqen procedurat ligjore për regjistrimin e sipërfaqes prej 190 m² në pronësi të qytetarit Stase, duke ndarë pasurinë nr. 1051/4, v. 4, f. 37, ZK3819 Voskopojë e llojit arë me sipërfaqe 140 m² sipas AMTP nr. 5979 dhe që rezulton sipas Printim III, ose LN (Librit të Ngastrave), 320 m², pra tepër e mbi kufirin ligjor. Pra të eliminohet mbivendosja e krijuar nga vetë ZVRPP Korçë, për pasurinë e fituar nga qytetari me VKKKP nr. 1273, datë 1.11.1996, ku sipas pikës 1, i kthehet 190 m² truall në Voskopojë, brenda vijave kufizuese të Fshatit, regjistruar ne nr hip 12/7, datë 28.7.1998 në regjistrin e fshatit, në zbatim të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”; ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar; dhe të ligjit nr.33/2012 datë 29.4.2012.

9.-Nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, pasi të verifikohen, identifikohet rregullshmëria e çeljes së 164 Kartelave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (KPP-ve), nga të cilat për 38 KPP të pasurive të Volumit 3, ZK nr. 3819, fshati Voskopojë janë kryer transaksione, të cilat të vulosen e firmosen KPP sipas faqeve nr. 3, 14,23,26, 35, 55, 83, 109,113, 117,132, 142, 143, 170,172, 173,178, 200,203, 221, 222, 31, 74,76, 81, 104, 217, 15, 24, 84, 219, 66, 82, 2, 220, në zbatim të rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 Kreu VI, pika 1.

10. -Nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë të nxirret akti (urdhri) dhe zbatohen procedurat për sistemimin e Kartelave të pasurive të paluajtshme KPP të volumit 10, ZK 3819 Voskopojë të cilat gjenden të korrigjuara numrat e faqeve për 140 faqe përkatësisht faqet 103-133, 138, 140-151,154-173 dhe 175-250. Për këto korrigjime të numrave të faqe të KPP-ve, nuk rezulton të përcaktohet shkak i korrigjimeve si dhe nuk rezulton të ketë urdhër të Regjistruesit, në zbatim të pikës 4.1, Kreu i II,dhe me pikat 1.4, 1.5, 1.6 të Kreut VI të Rregullores nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar ku shprehet se: “...Kur bëhen gabime ... regjistrimi bëhet në bazë të një vendimi të Regjistruesit ku të shpjegohet gabimi dhe të lejohet ndryshimi....”.

11.- Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr.33/2012, datë 29.4.2012 ”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor.

a.-Për pasurinë nr. 1044/13, v. 3, f. 250, ZK 3819 Voskopojë e llojit arë me sipërfaqe 330 m², pasi rezulton pa titull pronësie, dhe nuk përfshihet e nuk ekziston në AMTP nr. 5979, prandaj duhet të regjistrohet në pronësi “shtet”. Kjo kartelë është e pavulosur dhe e pa firmosur nga regjistruesi prej vitit 1999.

b.- Për pasurinë nr. 960/30,volumi 2, f. 127 ZK 3819 Voskopojë e llojit arë me sipërfaqe 310 m², regjistruar e lëshuar certifikatë datë 24.5.2011 sipërfaqe tepër ku AMTP nr.5979 ka 1860 m²,ndërsa LN, përcakton 1550 m², pra pa titull pronësie, urdhëruar e nënshkruar nga ish Regjistruesi, në kundërshtim me ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar.

c.- Për pasuritë nr. 1049/20, v. 11,f. 21, në sipërfaqen 200 m² arë dhe nr. 1049/21, v. 11, f. 22, në sipërfaqen 1100 m² arë të ardhura nga (pasuria nr. 1049/9, v. 4,f. 27 e llojit arë me sipërfaqe 1300 m² e ndarë më parë në dy pasuri),për të cilat janë lëshuar certifikatat e pronësisë datë 5.5.2011; pra dhënë sipërfaqe teper mbi AMTP nr. 5979 me referencën nr 1263, datë 7.2.2011, në kundërshtim me ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar.

12. Të nxirret urdhër kufizimi, në bazë të nenit 59, pika “b”, 60, 75 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për regjistrimin në ZK 8564:

a - të pasurisë nr. 6/664/1 me sipërfaqe trualli 280 m², regjistruar në volum 15, faqe 76, në llojin e pasurisë “truall”, pasi nuk është kthyer fizikisht nga vendimi KKKP nr. 1399, datë 02.02.1996 dhe të pasurisë nr. 6/748, me sipërfaqe 440 m², regjistruar në volum. 15, faqe 75, në llojin e pasurisë “truall”, pasi është krijuar mbivendosje midis tyre me rastin e kalimit nga hipoteka në sistem regjistrimi, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor, për disponimin e pronësisë.

b - mbi regjistrimin në volum 16, faqe 138 në ZK 8564 të pasurisë nr. 7/207/3 me sipërfaqe trualli 2345 m², pasi në rastin e ndarjes së kësaj pasurie që vijon në volum 18, faqe 223, 224, 225, 226 dhe 227 rezultojnë të regjistruara sipërfaqja 2700 m², pra është konstatuar një sipërfaqe prej 355 m² më shumë, në llojin e pasurisë “truall”, me rastin e kalimit nga hipoteka në sistem regjistrimi të dokumentacionit përkatës. Kjo pronë është njohur dhe kthyer me vendim të KKKP nr. 50, datë 15.5.1998, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

c - për regjistrimin në ZK 8564 të pasurisë nr. 6/544, në volum 34, faqe 189, duke regjistruar një sipërfaqe më tepër 10 m² truall dhe 15.8 m² ndërtesë, pa plan rievimi, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

d - për regjistrimin e 13 pasurive sipas pasqyrës nr. 14 “Kufizime pasurish ZK 8564” në të cilën janë bërë përshkrimi i mangësive përkatëse, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

e - për regjistrimin e 27 pasurive sipas pasqyrës nr. 16 “Kufizime pasurish ZK 3496” në të cilën janë përcaktuar emër mbiemër i përfituesit të AMTP-së dhe numri i saj, nr. i pasurisë, sipërfaqja më tepër dhe volum faqe që janë kryer veprimet, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

12/1.-Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa, për plotësimin e dokumentacionit të mangët dhe të munguar të pasurive të regjistruara dhe konkretisht;

- të pasurisë nr. 3/499, legalizuar sipërfaqe ndërtimi 209,49 m², shtesë kati (faktikisht kati 8) mbi një pallat shtatë katësh me sipërfaqe trualli 431 m², lloji i pasurisë “pallat”, regjistruar në volum. 36, faqe 230, pasi është regjistruar sipërfaqe ndërtimore 725.8 m² më shumë nga leja e ndërtimit, diferenca rezultojnë sipas bilancit të sipërfaqeve të regjistruara me aktkolaudimin dhe lejen e ndërtimit, pra rezultojnë me dalje ajrore. Veprimi i shkaktuar me rastin e kalimit nga hipoteka në sistem regjistrimi, deri në plotësimin e praktikës me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

13. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, që në bazë të ligjit nr. 9948 datë 07.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” neni 1 dhe neni 9, t’i kërkojë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, verifikimin e 11 AMTP me sipërfaqe 4827 m².

14. Regjistruesi i ZVRPP Korçë të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 39, neni 49 pika 1 dhe neni 59, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

a.- bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor për regjistrimin e pasurive të përfituara nga ligji i urbanistikës nr. 8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, sipas lejeve të Përdorimit, ligji i legalizimit nr. 9482, datë 03.04.2006, sipas lejeve të legalizimit dhe për truallin e përfitur në shkelje të procedurave sipas nenit 24/b të ligjit 7843, datë 13.07.1994 për sipërfaqen **prej 1398 m²** të trojeve në ZK 8562 dhe 8563 e regjistruar pa dokumentacion të ligjshëm pronësie, lëshuar nga institucionet kompetente (bashki, AKKP, AKP, në zbatim të VKM nr. 200, datë 19.2.2009 “Oborret në përdorim”).

b.-bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor për regjistrimin e pasurive të përfituara nga ligji i Urbanistikës nr. 8405, datë 17.9.1998 sipas lejeve të Përdorimit (i ndryshuar), ligjit të legalizimit 9482, datë 03.04.2006, sipas lejeve të legalizimit, dhe për pasuritë e përfituara nga ligji i Privatizimit të Banesave nr. 7652, datë 23.12.1992, për shkak të mangësive në dokumentacion në lidhje me studimin urbanistik dhe planvendosjet e miratuara nga bashkia.

c. Për 62 pasuri bujqësore me sipërfaqen prej 63069 m² të llojit arë dhe arë+truall, ZK. 1403 Fshati Çiflik, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve tepër ne pronësi “shtet”, Seksioni C, të fituara në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar, pasqyruar në tabelën nr. 2(10) “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela, ZK 1403 Fshati Çiflik Rrethi Korçë”.

d. Për 11 pasuri bujqësore me sipërfaqe 4827 m², të llojit arë dhe arë+truall, ZK. 1403 Fshati Çiflik, për të cilat është lejuar lëshimi i certifikatave të pronësisë dhe janë kryer transaksione, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin e sipërfaqeve tepër dhe regjistrimin ne pronësi Seksioni C “shtet”, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar.

e. Për 12 pasuri bujqësore me sipërfaqe 9970 m², të llojit arë dhe arë+truall ZK. 1403 Fshati Çiflik, për të cilat janë kryer transaksione dëshmi trashëgimie dhe kontrata shitblerje, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin e sipërfaqeve tepër dhe regjistrimin ne pronësi “shtet”, Seksioni C, përfitur tepër si pasojë e aplikimit të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991”Për tokën”, i ndryshuar.

15. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Korçë, që në të ardhmen specialistët të hartojnë hartat treguese të regjistrimit (HTR) dhe të plotësohet formulari shtojca 3, në zbatim të pikës 4, të UKM nr. 1, datë 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe pikës 10.6, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

16. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Korçë, që në të ardhmen dokumentacioni që administrohet në dosje të jetë i plotësuar me të gjitha të dhënat, në zbatim të nenit 107 pika 2 germa “dh”, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës Administrative”, i ndryshuar.

17. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP-së Korçë, që Kartelat e Pasurive të Paluajtshme të nënshkruhen vulosen me vulën e ZVRPP nga regjistruesi, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe të pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

18. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, që në ZK 1403, në KPP të vendoset datë përfundimtare të nënshkruhen nga regjistruesi dhe të vulosen me vulën e ZVRPP Korçë, në zbatim të pikës 23 paragrafi 3 dhe 4, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe pikës 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999 “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

19. Të merren masa, nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, që në zbatim të Rregullores “Për arkivimin e dokumenteve tekniko ligjore në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, Rregullores së Brendshme nr. 184 datë 08.04.1999, “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” si dhe UKM nr. 1, dt. 31.01.2007 “Për procedurat e regjistrimit në ZRPP”, të ndryshuar, të kryejë inventarizimin e dosjeve, të konfirmohet fleta e inventarit të dosjes nga dorëzuesi (specialistët) dhe marrësi (arkivisti), si dhe të ndërpriten praktikat e deritanishme të pranimit nga arkivi të dokumenteve të cilët nuk plotësojnë kriteret tekniko-ligjore.

20. Nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, të nxirret urdhri i brendshëm për zbatim, që në momentin e kryerjes së inventarizimit të dokumentacionit që ndodhet në referencë, të vendoset detyrimisht

numri i çdo dokumenti sipas radhës në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 24, germa “b” dhe të neneve 4 e 5, Kapitulli II-të, për “Detyrat e Sekretar-Arkivit të organit shtetëror” dhe “Rregullores për punën me dokumentet administrative të organeve shtetërore” detyrë që të zbatohet vazhdimisht.

21. Nga Regjistruesi i ZVRPP Korçë, të merren masat në mënyrë që kartelat e pasurive të paluajtshme të nënshkruhen nga punonjësi që kryen veprimet në kartelë, të plotësohet data përfundimtare, të mbyllën kartelat, si dhe të përcaktohet në cilin volum dhe faqe vijojnë pasuritë e ndara, si dhe të mos kryhen më veprime në kartela të pasurive të paluajtshme, me urdhër të panëshkruar dhe të pavulosur, nga Regjistruesi.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

ZVRPP Korçë, të kontabilizojë dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **325,721,¹⁰ lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit si më poshtë:

1. **20,683,¹⁰ lekë** nga e cila vlerës **9378, 6 lekë** për pasurinë nr. 2/31, në vol 27, faqe 113, zk 8561 dhe **11,304,⁵⁰ lekë**, për pasurinë nr. 3/342, vol. 14, faqe 137, zk .8561. nga mosllogaritjet dhe llogaritjet e gabuara të aktvlerësimeve të rivlerësimit të pasurisë.
2. **19,088 lekë**, që përfaqëson llogaritjen e pa saktë të tatimit të kalimit të drejtës së pasurisë së paluajtshme me aplikim nr. 440, datë 18.8.2011 për regjistrim rivlersimi pasurisë nr. 6/937.
3. **221,750 lekë**, për. pasurisë nr. 4/937 vol 41 faqe 233, zk. 8561 nga mos llogaritja e mos arkëtimi kamatëvonesave për regjistrime pasurie të vonuar.
4. **64,200 lekë** që përfaqëson kamatë vonesat e rrjedhura nga aplikimi për 428 ditë vonesa në regjistrimin fillestar të kontratës të shitblerjes nr. 564 rep dhe 305/1 kol datë 03.03.2010.

D. MASA DISIPLINORE

I- Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, nenet 37, 141, 153, ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **kërkojmë nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë**, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, për punonjësit përgjegjës si më poshtë:

1. “Vërejte me paralajmërim”, për 10 punonjës:

1. **zj. E.N.** përgjegjës i sportelit nr. 3,
2. **z. L.B.** me cilësinë ish specialist përpunues, ish zv. regjistrues
3. **zj. E.S.** me detyrë juriste dhe pritëse,
4. **z. H.K.** me detyrë specialist,
5. **zj. B.P.** me detyrë arshiviste,
6. **z. GJ.K.** me detyrë specialist, përpunues
7. **z. K.T.** me detyrë Jurist
8. **z. J.S.** me detyrë specialist, në cilësinë e përpunuesit
9. **zj. K.P.** me detyrë, në cilësinë e përpunueses
10. **z. A.D.** me detyrë specialist

2. “Zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale të punës”, për 4 punonjës:

1. **z. L.S.** me detyrë specialist, inxhinier
2. **z. GJ.K.** me detyrë specialist
3. **z. V.K.** përgjegjës i sportelit nr. 2
4. **z. A.E.** përgjegjës i sportelit nr. 1,

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, të paraqitur për ZVRPP Korçë.

E. KALLËZIM PENAL

D.I Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 710/10, datë 31.12.2013, kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, personat:

- 1- **z. K.B.** me detyrë ish-Regjistrues i ZVRPP-së Korçë.
- 2- **z. S.N.** me detyrë ish-specialist.
- 3- **z. Gj.K.** me detyrë specialist
- 4- **z. L.S.** me detyrë specialist
- 5- **z. V.K.** me detyrë specialist
- 6- **z. H.ZH.** me detyrë ish specialist
- 7- **z. E.Z.** me detyrë ish-jurist dhe përgjegjës i zyrave të hartografisë dhe juridike

ZVRPP Korçë ka pranuar dhe ka regjistruar pasuri të paluajtshme në papajtueshmëri të plotë të procedurave ligjore e nënligjore të përcaktuara në ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.20012, të UKM nr. 2, datë 08.4.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” germa “b” dhe “c”, dhe të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit dhe Privatizimit të Pronës Shtetërore.

Auditimi është kryer nga audituesit Selfo Zeneli, Agim Mandri dhe Qemal Meta më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT